



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 47  
Prishtinë, më 25 janar 2017, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**P r o c e s v e r b a l**

**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Eugen Cakolli, Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli, - KDI; Blerta Bejtullahu, - EU Office; Gurjeta Zeka, - LVV dhe media.

**Mbledhjen e kryesoi:** Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2017

**Elmi Reçica** fillimisht theksoi se organizimi i Samitit të kryetarëve të komisioneve të jashtme është një ngjarje e veçantë për Komisionin, për të cilin do të duhej të kyçet i gjithë Komisioni. Sa i përket Planit të punës tha se kemi një draft të Planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2017, ku janë të përmbledhura çështjet kryesore, të cilat Komisioni do t'i ketë në trajtim gjatë këtij viti. Lidhur me Planin e punës tha se nëse ndonjë anëtar i Komisionit ka ndonjë propozim, mund ta propozojë edhe pse gjatë procesit të punës, mund të rishqyrtohet dhe të plotësohet varësisht nga kërkesat dhe nevojat e Komisionit.

Njoftoj se nga KDI ka disa propozime shitesë për plotësimin e Planit të punës lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, edhe pse ne kemi paraparë dy tryeza lidhur me dialogun Kosovë –Serbi, si dhe raportimin e ministres për dialog. Propozimet nga KDI tha se janë:

-Organizim i dy takimeve të përbashkëta të komisioneve parlamentare dhe grupeve parlamentare për të diskutuar rreth dialogut Kosovë-Serbi,

-Organizimi i dy takimeve të përbashkëta/tryeza diskutimi në mes të komisioneve parlamentare dhe ekzekutivit rreth dialogut Kosovë-Serbi,

-Thirrja për raportim të ministrave/udhëheqësve të dialogut Kosovë-Serbi në përputhje me zhvillimet në procesin e dialogut.

-Një vizitë në terren/takim me qytetarët rreth zbatimit të marrëveshjeve të dialogut Kosovë-Serbi, dhe

-Kërkesë për realizimin e një hulumtimi parlamentar nga ekspertë të jashtëm në kuadër të projektit të KDI-së rreth temave/marrëveshjeve të dialogut Kosovë-Serbi.

Z. Reçica tha se e përkrah miratimin e Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017, me propozimet e bëra nga KDI.

**Puhie Demaku**, lidhur me draft- planin, propozoi që të përditësohet me vendimin e fundit të Komisionit, për raportimin e ministrit të Jashtëm lidhur me shërbimin e jashtëm dhe raportimin e ministrit të Brendshëm lidhur me Interpolin. Raportimi i ministrave sipas draft-planit përafërsisht nga dy herë në vit, tha se është i pamjaftueshëm dhe propozoi që ministrat të raportojnë katër herë në vit, lidhur me punët e jashtme apo edhe integrimet e dialogun. Ajo, po ashtu, propozoi që të shikohet mundësia e ndonjë vizite apo organizimi të ndonjë tryeze me pesë vendet që nuk e kanë njohur Kosovën. Pajtohet me pikat e propozuara nga KDI, e njëkohësisht theksoi se dialogu kohët e fundit po merë një format ndryshe, ku ka gjasa të ketë përfaqësime në nivel presidentësh. Nëse kjo do të ndodhë atëherë tha se ministrja për dialog do ta humb portofolin dhe se nuk dihet kush do të raportoj para Komisionit dhe çfarë do të ndodhë me transparencën.

**Elmi Reçica**, për draft- planin e punës, tha se është hartuar që të mos jetë tepër ambicioz. Theksoi se ekziston një projekt i cili u bisedua edhe në Strasburg, që domosdo gjatë këtyre dy muajve ta shfrytëzojmë Samitin, por edhe t'i vizitojmë qendrat e rëndësishme të cilat janë duke vendosur për të gjitha proceset. Lidhur me dialogun tha se po shihet se kështu nuk shkon realisht dhe është duke ndodhur ngritja e nivelit të dialogut. Sa i përket informimit lidhur me procesin e dialogut z. Reçica tha se kemi të drejtë t'i ftojme në raportim ministrat e tjerë, që janë pjesë e ekipit të dialogut dhe domosdo të kërkojmë raportim edhe në seancë plenare dhe nuk do të heqim dorë nga kërkesa për transparencë, llogaridhënie dhe debat për të gjitha çështjet e dialogut.

**Ismet Beqiri** tha se sa i përket sraft-planit të punës është një plan real i cili mund të realizohet dhe propozimet e KDI, vetëm sa e plotësojnë atë. Çështjen e raportimit për dialogun në Komision sipas formatit të ri, duhet ta shohim me gjithë mekanizmat parlamentar se si do të dizajnohet në të ardhmen, të cilit jo vetëm se duhet t'i përshtatemi, por edhe të kërkojmë që të gjejmë format parlamentare që të informohemi, e përmes nesh ta informojmë edhe opinionin, tha z. Beqiri. Ai vlerësoi se është e nevojshme të vihen kontakte me pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

**Pal Lekaj**, lidhur me Draft- Planin e Punës së Komisionit për vitin 2017, tha se ai i përmbush synimet tona për vitin 2017, por ne, si Komision, duhet të fokusohemi më tepër në politikat e jashtme, sidomos në dialogun me Serbinë. Me këtë format të dialogut Serbia e ka shfrytëzuar mundësinë, në mënyrën më të mirë të mundshme që të afrohet në Evropë, ndërsa ne kemi ngelur të izoluar. Qasja e Kosovës ndaj Serbisë tha se duhet të ndryshojë, sepse edhe pas gjithë këtyre viteve fare nuk ka ndryshime, përpos një fjalori luftënxitës. Në këtë drejtim politika parlamentare ka ngecur dhe duhet të jemi më insistues për kontakte, më këmbëngulës në vizita, sepse politika e BE-së ka një qasje krejt tjetër ndaj Kosovës, e sidomos me ndryshimet që po ndodhin, prandaj duhet të ndikojmë në afrimin e miqësisë me vendet që i kemi mike, por edhe me vendet që mendojnë ndryshe, t'i zbusim raportet. Z. Lekaj propozoi që Komisioni të ketë më tepër vizita në shtetet që janë vendimmarrëse për Kosovën. Sa i përket ri formatimit në dialog me Serbinë, tha se këtë çështje mund ta ngrehim në Kuvend, që të debatohet për krejt atë që po ndodh.

**Blerta Deliu Kodra** theksoi se draft-plani është i arsyeshëm, edhe pse nuk janë përfshirë një pjesë e agjendave të cilat ne mund t'i kemi gjatë vitit. Ministria Tahiri, në takim me Komisionin, tha se ka paralajmëruar se do të ketë fazë të re të dialogut, ku do të ketë edhe tema të vështira dhe involvim të Kuvendit. Në këtë drejtim do të duhej të ketë një angazhim më të shtuar të Komisionit, lidhur me çështjet të cilat do të preken në dialog, si çështja e të pagjeturve dhe t'i qasemi marrëveshjeve, me më tepër seriozitet. Theksoi se ka ndryshim të politikave jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon dhe do të ishte e nevojshme realizimi i disa vizitave të cilat kanë ngelur pa u realizuar nga viti i kaluar, e po ashtu edhe shtet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën të cilat është vështirë të ftohen në vizitë për shkak të qasjes që kanë ndaj nesh, do të ishte mirë të shikojmë mundësinë e qasjes ndaj tyre qoftë përmes shoqërisë civile apo mekanizmave të tjerë. Me organizimin e Samitit, ku kemi ftuar rreth 40 kryetarë të komisioneve të jashtme parlamentare, tha se është mirë ta shfrytëzojmë rastin dhe të bisedojmë lidhur me anëtarësimin e Kosovës në shumë mekanizma ndërkombëtarë e rajonal.

**Elmi Reçica** për pesë vendet që nuk na kanë njohur tha se është një angazhim i vazhdueshëm për të gjetur ndonjë ndërmjetësues nga ndonjë organizatë e fuqishme, për t'i realizuar disa vizita në këto vende. Ndërsa për vizitat në Shqipëri, Maqedoni e Bosnje e Hercegovinë tha se duhet diskutuar kohën, se kur është më e arsyeshme që t'i realizojmë.

**Zafir Berisha** tha se Draft- Plani i Punës së Komisionit i propozuar është një kornizë rreth së cilës ne duhet të angazhohemi, ndërsa aktivitetet të cilat mund të ndodhin kohë pas kohe na imponojnë edhe ndryshimet e agjendës së Komisionit. Sa i përket Planit të punës së vitit të kaluar tha se ka ngelur pa u realizuar vizita në Shqipëri, e që është shumë e rëndësishme për Komisionin nga se Shqipëria është anëtare e shumë mekanizmave ndërkombëtare, që i synon Kosova dhe vazhdon t'i ketë prioritet. Sa i përket bisedimeve me Serbinë, tha se përfaqësuesit e Kosovës është dashtë të jenë më transparent, nuk kanë qenë në krye të detyrës, nuk e kanë informuar opinionin se çka po ndodh në Bruksel dhe shpesh herë kanë krijuar amulli me deklaratat e tyre, si ministria e dialogut lidhur me heqjen e murit, e po ashtu dhe deklaratat e Presidentit, të cilët nuk po veprojnë konform rrethanave dhe nuk po e shfrytëzojnë pozitën e

tyre ashtu siç duhet. Z. Berisha tha se ne, si deputetë, duhet të gjejmë një formë, që të jemi më të informuar rreth asaj që po ndodh në Bruksel dhe të mos informohemi nga mediat.

**Elmi Reçica** theksoi se duhet të insistojmë që çdo marrëveshje e nënshkruar ta kemi edhe para se ajo të nënshkruhet, ndërsa sa i përket situatës tha se ajo është e acaruar dhe shkuarja tani në këtë takim për dialog, është bërë me ftesë të Brukselit.

**Qerim Bajrami**, sa i përket vizitës në Bosnje, tha se ne i kemi pasur garancionet për marrjen e vizave në Shkup, për udhëtimin në Bosnje e Hercegovinë, por ka qenë fundi i vitit dhe kemi pasur obligime të tjera, prandaj është shtyrë vizita. Propozoi që vizita në Bosnje të realizohet ose në fund të muajit shkurt ose në fillim të muajit mars, por të jetë para vizitës në Shqipëri. Në vizitën që e kemi pasur në Bruksel njoftoi se evrodeputetja nga Kroacia, ish -ambasadore e Bosnje Hercegovinës në Romë, ka thënë se nuk do të ndryshojnë raportet në mes të Bosnjës e Kosovës nëse nuk ndërhyjnë Brukseli, Beogradi e Prishtina. Këtë ide z. Bajrami tha se nuk e përkrah, ngase nuk është e mirë për ne dhe se duhet të punojmë që të përmirësojmë marrëdhëniet me Bosnjën sepse dirigjimi në Bosnje vije nga Beogradi që të mos ketë kurrfarë marrëdhënie me shqiptarët. Nga ana e Kosovës tha se nuk është ndërmarrë asgjë që këto raporte të përmirësohen me Bosnjën. Theksoi se kërkesa e jonë është që të hapet një mision i përbashkët me Shqipërinë, në Bosnje i cili do të kryente shumë shërbime për qytetarët tanë. Z. Bajrami propozoi që në Planin e punës të parashihet edhe raportimi i ministrit të Diasporës.

**Elmi Reçica** propozoi që Komisioni së pari të bëjë një vizitë në Shqipëri dhe të diskutohet çështja e hapjes së një misioni të përbashkët në Sarajevë, kërkesë e cila tha se do të involvonte edhe ministrat e jashtëm.

**Luljeta Veselaj -Gutaj** për Draft-Planin e Punës së Komisionit, tha se është një plan i realizueshëm, ndërsa prioritet të Planit të punës së Komisionit tha se sheh shkuarjen në vizitë në pesë vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën apo organizimin e një tryeze të përbashkët me ta. Përgëzoi organizimin e Samitit të kryetarëve të komisioneve të jashtme për të cilin tha se është shumë i rëndësishëm sepse do të kemi mundësinë që të llojmë te shtetet e rajonit që të na mbështesin edhe më tutje. Sa i përket dialogut tha se ka lëvizje për riformatim dhe se presim raportim nga dialogu qoftë nga ministrja, qoftë nga delegacioni i cili është duke na përfaqësuar.

**Puhie Demaku** duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Bajramit tha se marrëveshja për përfaqësim të përbashkët konsullor e nënshkruar në mes të Shqipërisë dhe Kosovës është e bazuar në Konventën e Vjenës, e cila Konventë nuk parasheh përfaqësim të përbashkët, në vendet të cilat nuk na kanë njohur.

Pas diskutimit të anëtarëve të Komisionit lidhur me Planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2017, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

*P ë r f u n d i m*

*Miratohet Plani dhe programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për vitin 2017, me plotësimet e anëtarëve të Komisionit dhe KDI-së.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Elmi Reçica